

sagemax

Udhëzimet e përdorimit

NEXZr[®].S

NEXZr[®].T

NEXZr[®] +

NEXZr[®] + MULTI

Tabela e përmbajtjes

Karakteristikat materiale	3
Të dhënat teknike	3
Skeda e të dhënave të sigurisë (SDS)	4
Garancia/magazinimi	4
Vendosja/Modelimi dhe frezimi	5
Infiltrimi	5
Rekomandimet për sinterizimin	6
Rëra me presion/paspërpunimi	7
Veshja me porcelan/ngjyrosja dhe glazura	7
Cementimi	8

Karakteristikat materiale

Disqet "NexxZr®" përbëhen nga oksid zirkoni (Y-TZP ZrO_2) për përdorime në stomatologji.

Ky material është krijuar në mënyrë specifike për prodhimin e protezave të përhershme dentare.

Te përdorimet përfshihen: Urat dhe kurorat anteriore dhe posteriore, koronat teleskopike me formë konike.

Pas përfundimit të sinterizimit të specifikuar përfundimtar i gjithë zirkoni "Sagemax NexxZr" plotëson kërkesat e EN ISO 6872.

Të dhënat teknike

Përbërja

Materiali / Produkti	NexxZr S	NexxZr T	NexxZr +	NexxZr + Multi
Oksid zirkoni ZrO_2	≥ 89%	≥ 89%	≥ 85%	≥ 86%
Oksid itriumi Y_2O_3	4 – 6%	4 – 6%	7 – 9%	6,5 – 8%
Oksid hafniumi HfO_2	≤ 5%	≤ 5%	≤ 5%	≤ 5%
Oksid alumini Al_2O_3	< 1%	< 1%	< 1%	< 1%
Tretshmëria kimike [$\mu\text{g}/\text{cm}^2$]	< 100	< 100	< 100	< 100

Karakteristikat

Materiali / Produkti	NexxZr S	NexxZr T	NexxZr +		NexxZr + Multi
Zgjerimi linear termik / CTE [10^{-6} K^{-1}]	$10,1 \leq \text{CTE}^* \leq 11,1$ (*diapazoni 25 – 500°C)	$10,1 \leq \text{CTE}^* \leq 11,1$ (*diapazoni 25 – 500°C)	$9,6 \leq \text{CTE}^* \leq 10,6$ (*diapazoni 25 – 500°C)		$9,9 \leq \text{CTE}^* \leq 10,9$ (*diapazoni 25 – 500°C)
Rezistenca në përkulje [MPa] ¹	1370	1270	e bardhë	me nuancë	880
			1000	880	
Rezistenca ndaj thyerjes [MPa·m ^{1/2}] ¹	≥ 5	≥ 5	≥ 3,5		≥ 3,5
Tejdukshmëria [1-CR]*100	30%	42% ²	46% ²		46%
Lloji/klasa	Lloji II / klasa 5	Lloji II / klasa 5	e bardhë	me nuancë	Lloji II / klasa 4
			Lloji II / klasa 5	Lloji II / klasa 4	

¹ vlerat e zakonshme sipas ISO 6872 (kampion i polishuar)

² disqet me nuancë tregojnë vlera më të ulëta

Skeda e të dhënave të sigurisë (SDS)

Përbërësit e rrezikshëm

Zirkon (Oksid zirkoni)	Numri CAS	1314-23-4
	Përqindja	91 – 96%
	ACGIH TLV	5 (T)
	OSHA PEL	5 (T)
	Njësitë	mg/m ³
Itrium (Oksid itriumi)	Numri CAS	1314-36-9
	Përqindja	4 – 9%
	ACGIH TLV	5 (T)
	OSHA PEL	5 (T)
	Njësitë	mg/m ³

Të dhënat e rrezikut për shëndetin

Format e ekspozimit:

X Kontakt me lëkurën

N/A Përthithje nga lëkura

X Kontakt me sytë

X Frymëmarrje akute

X Frymëmarrje kronike

X Gëlltitje

Procedurat e urgjencës dhe të ndihmës së shpejtë

– Frymëmarrje

Nëse zhvillohen simptoma ku merr pjesë mushkëria (kollitje, dihatje, mosmbushje me frymë etj.) largojuni ekspozimit dhe kërkonti kujdesin mjekësor.

– Kontakt me lëkurën/sytë

Nëse ka iritrim, shpëlajeni me ujë të bollshëm. Nëse iritimi vazhdon, kërkonti kujdesin mjekësor.

– Gëlltitje

Nëse kapërdihen sasi të konsiderueshme, hollojeni me ujë të bollshëm. Provokoni të vjella dhe kërkonti kujdesin mjekësor.

Garancia/magazinimi

Garancia

- Informacioni teknik dhe rekomandimet e përdorimit, qoftë kur jepen gojarisht, qoftë kur jepen me shkrim, si dhe trajnimi praktik janë të gjitha direktiva.
- Furrat e sinterizimit ndryshojnë në performancë. Është tejet e rëndësishme që furrat të kalibrohen rregullisht për të pasur rezultate optimale. Ndiqni udhëzimet e kalibrimit sipas rekomandimeve të prodhuesit.
- Produktet tona janë në zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm. Do t'ju këshillojmë për ndryshime të tilla.
- Ne punojmë për të ofruar produkte të cilësisë maksimale. Kur ta merrni produktin inspektojeni për defekte të dukshme përpara frezimit.
- Pasi disqet dhe blloqet të jenë frezuar pjesërisht, cdo pretendim dhe ankese konsiderohet i pavlefshëm.

Ruajtja

Ruajeni të gjithë zirkonin "NexxZr" në paketimin fillestar në një ambient të thatë në temperaturë normale dhome.

Vendosja/Modelimi dhe frezimi

Udhëzimet e përdorimit

Indikacionet	Materiali	NexxZr S	NexxZr T	NexxZr +	
Restaurime me njësi të vetme (anteriore/posteriore)		✓	✓	✓	
Ura me 3 njësi (anteriore/posteriore)		✓	✓	✓	
Ura me shumë njësi (anteriore/posteriore)		✓	✓	e bardhë	me nuancë/Multi
				✓	–

- Vetëm për përdorim në tregun kanadez: Ura duhet kufizuar në 6 njësi me maksimumi 2 trupa ure.

Kundërindikacionet

- Reduktim i pamjaftueshëm i strukturës së dhëmbëve.
- Strukturë e pamjaftueshme për ngjytjen dhe shpërndarjen e duhur të forcave.
- Higjienë e pamjaftueshme vetjake.
- Hapësirë e pamjaftueshme e ndërmjetme për bashkimet e nevojshme në ura.
- Alergji të njohura.
- Mospërputhje të njohura ndaj përbërjes së produktit.

Modelimi dhe frezimi

- Ndiqni udhëzimet për softuerin CAD/CAM për skanim dhe modelim restaurimesh.
- Sistemet e frezimit duhet të kalibrohen për rezultate optimale. Jo të gjitha sistemet janë njësoj dhe për pasojë mund të kenë rezultate negative nëse nuk ruhet trashësia minimale.
- Për urat, modeloni gjithnjë suporte ndihmëse për të evituar deformimin gjatë sinterizimit.

Infiltrimi

Infiltrimi i restaurimeve "NexxZr" përpara sinterizimit

- Ndiqni udhëzimet përkatëse për përdorimin e furnizuesit



PARALAJMËRIM!

- Përdoruesi duhet të marrë masa kur përdor zirkon të pasinterizuar. Punoni gjithnjë në ambient të ajrosur mire.
- Përdorni doreza sintetike kur mbani zirkon dhe lëngje të parangjyrosura.
- Lëngjet e parangjyrosura nuk duhet të bien në kontakt me lëkurën.
- Përdorni vakuumin e duhur në zonë të mirajrosur për të kapur e bllokuar pluhurat.

Rekomandimet për sinterizimin

Furrat e sinterizimit ndryshojnë në performancë. Është tejet e rëndësishme që furrat të kalibrohen rregullisht për të pasur rezultate optimale.

	Numri i njëjësive	Kohëzgjatja (orë)	Faza	Temperatura (°C)	Ngrohja / Ftohja (°C/min)	Koha e qëndrimit (min)
NexxZr S, NexxZr T, NexxZr +						
Standarde	1 – 5	~3,7	Faza 1	20 – 1300	30	30
			Faza 2	1300 – 1530	40	60
			Faza 3	1530 – 900	15	–
			Faza 4	900 – 80	20	–
	5 – 10	~5,2	Faza 1	20 – 1300	30	60
			Faza 2	1300 – 1530	40	120
			Faza 3	1530 – 900	15	–
			Faza 4	900 – 80	20	–
E zgjatur	1 – 20	~10,8	Faza 1	20 – 900	10	10
			Faza 2	900 – 1530	3	150
			Faza 3	1530 – 80	8	–
	>21	~12,8	Faza 1	20 – 900	10	10
			Faza 2	900 – 1530	3	210
			Faza 3	1530 – 80	8	–
Gjatë natës	E pakufizuar	~14,3	Faza 1	20 – 250	2	–
			Faza 2	250 – 1530	4	240
			Faza 3	1530 – 80	8	–
NexxZr + Multi						
Speed	1 – 5	~3,6	Faza 1	20 – 1000	60	10
			Faza 2	1000 – 1530	3	60
			Faza 3	1530 – 1100	50	–
			Faza 4	1100 – 80	60	–
E zgjatur	E pakufizuar	~9,5	Faza 1	20 – 900	10	30
			Faza 2	900 – 1500	3	120
			Faza 3	1500 – 900	10	–
			Faza 4	900 – 300	8	–

- Vendosini sendet për tu sinterizuar në profilet e sirtarit të sinterizimit.
- Lini hapësirë për sendet në sirtar për të ndihmuar ngrohjen me konveksion.
- Sendet e sinterizuara do të marrin një shkëlqim të lehtë.



PARALAJMËRIM!

- Furrat e sinterizimit duhet të vendosen në zona të ajrosura mire me mbrojtje kundër zjarrit.
- Ftohja e ngadaltë është thelbësore për rezultatin përfundimtar; mos e ftohni shumë shpejt.
- Nëse e hapni furrën para kohe mund të shkaktoni plasaritjen e zirkonit.

Rëra me presion/paspërpunimi

Përshtatja e kontureve

Pas sinterizimit përfundimtar, restaurimet me zirkon mund të përshtaten dhe formësohen me anë të frezave të përshtatshme abrazive me diamant. Përdorni turbinë laboratorike me ftohje me ujë për të parandaluar thyerjen.

Tolerancat mund të ngushtohen duke përdorur rrota abrazive gome të butë, të krijuara posaçërisht për përdorime të tilla.

Rëra me presion

Pas kryerjes së rregullimeve, kurora ose ura duhet të punohet me rërë me presion me oksid alumini 50 µm të bardhë të pastër në afro 2,5 bar.

Ri - sinterizimi

Pas pastrimit me rërë me presion dhe avull, sendet duhet të risinterizohen në furrë porcelani për të izoluar mikrofrakturat që mund të jenë shfaqur gjatë gërryerjes.

Ngriheni temperaturën në 40°C/min në 1000°C. Mbajeni në ajër për 5 minuta. Ftoheni me ngadalë në temperaturën e dhomës. Restaurimet janë tani gati për polishim, ngjyrosje dhe glazurë.



PARALAJMËRIM!

- Gërryerjet mbi zirkon të sinterizuar duhet të kryhen në zona të ajrosura mire.
- Mos thithni pluhurin e grimcave.
- Përdorni njësi të përshtatshme vakuumi për thithjen e pluhurit.
- Përdorni syze sigurie gjatë gërryerjes dhe punimit me rërë me presion.
- Pastroni me rërë me presion vetëm një njësi të miratuara me vakuum.

Veshja me porcelan/ngjyrosja dhe glazura

Polishimi

- Sipërfaqes së zirkonit i duhet vendosur një shtresë e hollë porcelani ngjitës, dhe duhet pjekur në furrë porcelani.
- Aplikoni zir liner sipas nevojës.
- Ndiqni rekomandimet e prodhuesit për parametrat e pjekjes.
- Ndiqni informacionin teknik për koeficientin e bymimit termik për zirkonin si dhe për koeficientin e shtresës së porcelanit.

Ngjyrosja dhe glazura

- Ngjyrosni dhe glazuroni në shtresa të holla për të arritur shkelqimin e preferuar.
- Përdorni ngjyrues dhe glazura të krijuara për përdorim me zirkon.
- Përdorni rekomandimet e prodhuesit për parametrat e pjekjes.

Paspërpunimi nga dentisti

Kur nevojiten rregullime okluzale dhe proksimale nga dentisti, rekomandohet të përdoren freza abrazive me diamant për punime të imeta. Restaurimet duhet të ftohen gjatë procesit të gërryerjes. Niveli i gërryerjes së diamantit duhet të jetë afro 40 mikronë.

Pas gërryerjes, lëmojini sipërfaqet me polishues të rrumbullakët gome dhe lustroni me pastë lustrimi diamanti 10-mikronësh.

Kini parasysh që nëse restaurimi nuk lustron mjaftueshëm, antagonisti mund të pësojë abrazion me kalimin e kohës.

Cementimi

Cementimi konvencional

Karakteristikat origjinale të zirkonit "NexxZr" i japin forcë dhe qëndrueshmëri maksimale. Ndaj fiksimi konvencional me fosfat oksidi zinku apo cement glass ionomer nuk është i mundur në shumicën e rasteve. Pastroni lehtë me rërë me presion brenda restaurimit me oksid alumini 50 mikronësh të bardhë të pastër dhe pastroni me avull përpara cementimit.

Kur përdorni teknikën e zakonshme të cementimit, është e rëndësishme të ndiqni kërkesat e sakta të ngjitjes se abutmentit.

Fiksimi me ngjitës

Për fiksimin me ngjitës, rekomandojmë kompozitin e ngjitjes "SpeedCEM® Plus". Këto cemente ngjitëse krijojnë një ngjitje të shkëlqyer midis strukturës së dhëmbëve dhe materialit të skeletit me oksid zirkoni.

Fiksimi i përkohshëm me zirkon

Ndonëse nuk rekomandohet, nëse restaurimi duhet të vendoset përkohësisht, duhet bërë kujdes gjatë heqjes pasi skeleti mund të dëmtohet.

sagemax



Prodhuar nga:

Sagemax Bioceramics, Inc.

34210 9th Avenue S, Ste. 118

Federal Way, WA 98003 USA

Tel. : +1 253-214-0389

support@sagemax.com

www.sagemax.com

E	C	R	E	P
---	---	---	---	---

Përfaqësuesi për KE-në:

AB Ardent

Generatorgatan 8

SE-19560 Arlandastad Sweden

Tel.: +46 8594 412 57

eu1@sagemax.com

www.sagemax.com

CE 0123

RX only

Data: 2019-03-26/Rev.5
SQ